



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 81

13 korrik

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Rregullore e MMPAU nr. 12, datë 4.6.2012	Për përcaktimin e procedurave për pajisjen me leje peshkimi dhe të konkurrimit publik për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në det, në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore detare 3693
Vendim i ERE nr. 66, datë 6.6.2012	Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike nga të licencuarit për aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike 3714

RREGULLORE
Nr. 12, datë 4.6.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR PAJISJEN ME LEJE PESHKIMI
DHE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË
SË PESHKIMIT NË DET, NË UJËRAT E BRENDSHME
DHE AKUAKULTURËN TOKËSORE DHE UJORE DETARE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të germave “ë” dhe “i” të nenit 32 të ligjit nr. 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 13.5.2009 “Për procedurat dhe çmimet për dhënien me qira të sipërfaqeve ujore për qëllime të akuakulturës intensive”, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave miraton rregulloren si më poshtë:

KREU I
QËLLIMI

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për:

- a) aplikimin për leje peshkimi, shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit që e shoqëron atë dhe lëshimin e aktit të miratimit të saj;
- b) mënyrën e zhvillimit të konkurrimit publik për ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe detare;
- c) zbatimin e lejeve nëpërmjet kriterëve ligjore e teknike, të përcaktuar në kontratë dhe/ose lejen përkatëse.

KREU II
KËRKESA DHE DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Neni 2

Llojet e lejeve dhe e drejta për ushtrim aktiviteti në peshkim dhe akuakulturë

1. Në peshkimin detar me mjete lundruese me dhe pa kuvertë, motobarka ose anije peshkimi, për peshkim fundor, peshkim i pellagjikëve të vegjël dhe/ose të mëdhenj, peshkim molusqesh, selektive dhe peshkim bregdetar jepet leje peshkimi, e cila akordohet për çdo mjet lundrues të veçantë.

2. Për ujërat e brendshme, e drejta e peshkimit dhe akuakulturës fitohet nëpërmjet konkurrimit publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7908/1995, të ndryshuar dhe me subjektin fitues Ministria lidh kontratë të zhvillimit të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

3. Personat fizikë ose juridikë të interesuar për zhvillimin e akuakulturës, tokësore dhe detare, në pronat publike, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik. Me fituesin, Ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh kontratë qiraje. Procedurat për lidhjen e kontratës dhe ato të konkurrimit publik nuk zbatohen në rastet kur toka është në pronësi private.



Neni 3

Aplikimi dhe kërkesat për leje peshkimi në det

1. Aplikimi bëhet pranë QKL-së për format e peshkimit që janë të parashikuara për t'u pajisur me leje.

2. Dokumentet e domosdoshme për leje janë si më poshtë:

I. Për mjetin lundrues me kuvertë:

- a) kërkesa e subjektit;
- b) dëshmi pronësie (nga Kapiteneria e Porteve);
- c) dëshmi flamuri (nga Kapiteneria e Porteve);
- d) certifikatë lundrimi (nga Regjistri Detar);
- e) certifikatë regjistrimi në QKR.

II. Për mjetin lundrues pa kuvertë (për peshkim artizanal):

- a) kërkesa e subjektit;
- b) libri i mjetit lundrues (nga Kapiteneria e Porteve);
- c) dokumenti i regjistrimit të mjetit lundrues (nga Policia Kufitare) ose vërtetim aplikimi pranë saj;
- d) certifikatë regjistrimi në QKR.

Dokumentacioni shqyrtohet nga MMPAU-ja nëpërmjet KSHLMLP-së pas vlerësimit nga Drejtoria e Peshkimit (Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave) brenda afateve ligjore të përcaktuara. Vendimi i marrë nga KSHLMLP-ja i përcillet subjektit nëpërmjet QKL-së. Në rast refuzimi në aktin e refuzimit jepen edhe arsytet e refuzimit.

Neni 4

Aplikimi dhe kërkesat për konkurrimin publik për aktivitetin në ujërat e brendshme dhe akuakulturë

1. Për konkurrimin publik për ujërat e brendshme dhe akuakulturë, ministri ngre komision për vlerësimin e kërkesave, i cili ka detyra të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

2. Drejtoria e Peshkimit grumbullon, regjistron, verifikon kërkesat e ardhura për zhvillim aktiviteti në akuakulturë dhe ujëra të brendshme së bashku me statusin e objektit ujor të kërkuar. Objektet ujore, pasi seleksionohen dhe kategorizohen, renditen në listën për shpallje për konkurrim publik, të cilat, paraprakisht dërgohen për mendim tek të gjithë anëtarët e Komisionit.

3. Drejtoria e Peshkimit krijon një regjistër elektronik të të gjitha kërkesave të ardhura, duke specifikuar në të emrin e kërkuarit, datën, zonën, llojin e aktivitetit të kërkuar, si dhe mbylljen e praktikës.

4. Njoftimi për botim për konkurrim të një kategorie të veçantë për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturë shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për objektin ujor, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

5. Drejtoria e Peshkimit mban një listë (që përditësohet çdo muaj nga ana e sektorit të kontrollit për peshkimin) të subjekteve që rezultojnë kundërvajtës të legjislacionit të peshkimit dhe/ose debitorë, me qëllim që të mbahet parasysh në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit për konkurrim nga ana e komisionit të vlerësimit të kërkesave. Drejtoria e Peshkimit tërheq mendimin teknik të vëzhguesve të saj për objektin që do të shpallet për konkurrim.

6. Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve dërgon për publikim listën finale të objekteve ujore dhe/ose listën e impianteve fikse të kultivimit të midhjeve në liqenin e Butrintit, që është përgatitur nga Drejtoria e Peshkimit.

7. Dokumentacioni i përgjithshëm që paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim është:

a) kërkesa për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në objektin ujqor të shpallur për konkurrim;

b) regjistrimi në QKR për objektin e veprimtarisë, së bashku me ekstraktin historik;

c) planbiznes për zhvillimin e veprimtarisë;

d) projekt teknik dhe dokumentacioni i nevojshëm teknik e ligjor;

e) niveli i investimit;

f) niveli i punësimit;

g) vetëdeklarim se projekti përputhet me kërkesat mjedisore të zonës në fjalë;

h) pagesa e tarifës së shërbimit.

i) vërtetim nga organet tatimore që subjekti në fjalë nuk ka detyrime tatimore.

8. Dokumentacioni i veçantë që paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim, sipas kategorive ujore dhe llojit të aktivitetit, është si më poshtë:

a) Për akuakulturën:

i) prania e specialistit të fushës nëpërmjet CV-së profesionale, ku të tregohet përvoja në fushën e peshkimit dhe akuakulturës;

ii) planvendosja e shprehur në një hartë topografike me shkallën 1: 25 000, me koordinata metrike duke treguar distancën nga subjekti më i afërt i peshkimit apo ndonjë aktivitet tjetër;

iii) garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

b) Për ujëmbledhësit e bujqësisë:

i) marrëveshje ose kontratë përdorimi uji ose ujëmbledhësi me përfaqësuesin e organit që administron atë ujëmbledhës;

ii) hartë topografike në shkallën 1:25 000, si dhe karakteristikat teknike nga bordi i kullimit;

iii) garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

c) Për lagunat bregdetare, jo me dajlan:

i) hartë topografike në shkallën 1:25 000;

ii) planvendosja e instalimeve peshkore me koordinata metrike, në sistemin Gauss-Krüger;

iii) lloji i mjeteve të peshkimit;

iv) sasia (gjatësi dhe/ose numër);

v) garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

d) Për lumenjtë, bilance dhe stavnikë:

i) Planvendosja e instalimit të mjetit/mjeteve të peshkimit me koordinata metrike, duke treguar distancën nga subjekti më i afërt i peshkimit apo i ndonjë aktiviteti tjetër.

ii) lloji i mjeteve të peshkimit;

iii) sasia (gjatësi dhe/ose numër);

iv) garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

e) Të tjera, si: grumbullim/kultivim molusqesh bivalvorë:

i) kategorizim nga autoriteti veterinar i zonës;

ii) lista dhe vendosja e të gjitha derdhjeve nga toka në det në raport me zonën ku synohet të zhvillohet aktiviteti, e paraqitur në hartë topografike me shkallën 1:25 000;

iii) llojet që synohen të kultivohen ose grumbullohen;



- iv) kontratë paraprake me një qendër depurimi, nëse synohet të tregtohet e gjallë dhe/ose kontratë me një qendër përpunimi termike, të certifikuara nga AKU-ja;
- v) garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.
- f) Për kultivimin e midhjes në impiante fikse në liqenin e Butrintit:
 - i) kontratë paraprake me një qendër depurimi, nëse synohet të tregtohet e gjallë dhe/ose kontratë me një qendër përpunimi termike, të certifikuara nga AKU-ja;
 - ii) elementet kryesore të teknologjisë që do të praktikojë në kultivimin e midhjes, intensitetin e prodhimit dhe prodhimtarinë vjetore;
 - iii) vërtetim nga DSHMP-ja, Sarandë që nuk kanë detyrime financiare ndaj MMPAU-së në lidhje me tarifën e lejes dhe kontratën e qirasë (për subjektet ekzistuese);
 - iv) vërtetim mbi garancitë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve prodhuese të parashikuara në planbiznes, duke parashikuar edhe shumën që i nevojitet për mirëmbajtjen dhe/ose riparimin e impiantit/ve për të cilët konkurron.
- g) Për peshkimin artizanal me instalim stavniku në bregdet:
 - i) koordinatat detare, ku do të instalohet stavniku me koordinata metrike me sistemin Gauss-Krüger;
 - ii) paraqitja skematike e stavnikut dhe distanca me objektin më të afërt të peshkimit dhe apo të akuakulturës;
 - iii) eventualisht, mjetet e lundrimit dhe dokumentacioni përkatës i tyre;
 - iv) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.
- h) Për lagunat bregdetare me instalim dajlani:
 - i) harta e lagunës/njësisë lagunore me karakteristikat fizike (sipërfaqja, gryka/t e komunikimit me detin etj.). Harta duhet të jetë topografike me shkallën 1:25 000;
 - ii) planinstalimi i dajlanit dhe projekti teknik i tij;
 - iii) lloji, sasia e mjeteve dhe e veglave të tjera të peshkimit;
 - iv) plani i administrimit të lagunës;
 - v) vërtetim mbi mundësitë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

Neni 5

Kriteret e konkurrimit

Kriteret e konkurrimit për të gjitha kategoritë ujore janë:

- a) niveli i investimit;
- b) teknologjia e projektit;
- c) niveli i punësimit.

Neni 6

Nivelet e vlerësimit

1. Nivelet maksimale të vlerësimit për të gjitha kategoritë ujorë janë:

- a) niveli i investimit 40 pikë;
- b) teknologjia e projektit 40 pikë;
- c) niveli i punësimit 20 pikë;

d) në rast klasifikimi me pikë të barabarta, CV-ja e subjektit dhe eksperiencia në aktivitet ka përparësi.

2. Detajimi i kriterëve të vlerësimit bëhet sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, pjesë përbërëse e saj.

3. Monitorimi i zbatimit të kushteve të kontratave dhe zbatimit të planbizneseve të paraqitura për konkurrim është detyrë e monitoruesve të Drejtorisë së Peshkimit.

4. Një kopje e planbiznesit të paraqitur për konkurrim nga subjekti fitues depozitohet në Drejtorinë e Peshkimit për t'u përdorur në monitorimin e aktivitetit, sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 7

Detyrat e komisionit të vlerësimit të kërkesave

1. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

- a) përgatit dokumentacionin për publikim dhe e shpall atë;
- b) hap në prani të konkurrentëve dokumentacionin e paraqitur prej tyre, duke bërë të njohur të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti skualifikohet;
- c) komisioni i vlerësimit vazhdon vlerësimin edhe në rast se për zonën e shpallur për konkurrim paraqitet një kërkesë e vetme;
- ç) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkaku, konkurrentët e kualifikuar dhe lista e dokumenteve të paraqitura prej tyre;
- d) bën shqyrtimin, brenda 20 ditëve kalendarike, të dokumentacionit të paraqitur dhe vlerëson me pikë sipas çdo elementi konkurrimi, dhe përcaktimeve në njoftim;
- e) verifikon nëse subjekti kërkues është dënuar ose jo, në procedurë për shkelje ligjore në peshkim dhe/ose është debitor;
- f) rendit, pas përfundimit të konkursit, konkurruesit në bazë të pikëve të fituara;
- g) paraqet te Ministri, brenda afatit të përcaktuar në germën "d" të kësaj pike, një informacion për zhvillimin e konkursit, së bashku me procesverbalin dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara, për të kërkuar miratimin e procedurës;
- h) komisioni i vlerësimit shpall subjektin/et fitues/e. Njoftimi për shpalljen fitues vendoset në këndin e njoftimeve të Ministrisë, si dhe dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve;
- i) kontratat përgatiten nga ana teknike nga Drejtoria e Peshkimit mbi bazën e kontratës tip që ndodhet në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje;
- j) për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis dhe që duhen pajisur me leje mjedisore, kontrata lidhet pas pajisjes së subjektit fitues me leje mjedisore;
- k) një kopje të lejeve dhe kontratave të lidhura i dërgohet Drejtorisë së Kontrollit për Mjedisin.

Neni 8

Ankimi

Subjektet konkurruese, brenda 7 ditëve kalendarike nga shpallja e subjektit fitues në APP, kanë të drejtën e ankimit te Ministri, i cili brenda 10 ditëve kalendarike shprehet me shkrim.

Neni 9

Lidhja e kontratës

1. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, Ministria lidh kontratën e zhvillimit të aktivitetit, miraton kohëzgjatjen e projektit.



2. Kohëzgjatja e kontratës është:

- a) deri në 10 vjet për ujërat e brendshme;
- b) deri në 10 vjet për ujërat e brendshme me dajlan;
- c) deri në 10 vjet për akuakulturën intensive;
- d) deri në 10 vjet për impiantet e midhjeve në Butrint;
- e) deri në 5 vjet për peshkimin me bilanxhe, rrahce dhe stavnikë.

Neni 10

Ndërprerja e lejes dhe prishja e kontratës

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, ndërprerja e vlefshmërisë së lejes dhe prishja e kontratës për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturë bëhet mbi bazën e konstatimeve të kundërligjshmërisë, të cilat pasqyrohen në akte të shkruara nga inspektorët e peshkimit dhe më pas merren në shqyrtim nga Komisioni përkatës i ngritur për këtë qëllim.

2. Vendimi i komisionit për ndërprerjen e kontratës i lëshohet me shkrim subjektit të kontraktuar.

Neni 11

Ndërprerja e lejes dhe prishja e kontratës

1. Leja ose kontrata humbet vlefshmërinë në mënyrë të përkohshme:

- a) kur subjektit fizik ose juridik i ndalohet të zhvillojë aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës nga vendimi i komisionit të ngritur mbi bazën e ligjit;
- b) në rastet kur subjekti fizik ose juridik kryen shkelje të parashikuara nga legjislacioni i peshkimit sipas neneve për kundërvajtjet administrative dhe dënimet plotësuese;
- c) zotëruesi i lejes/kontratës është i detyruar të dorëzojë pranë inspektorit të peshkimit ose zyrës së inspektoratit të peshkimit në rrethin përkatës dokumentin e lejes/kontratës.

2. Leja ose kontrata humbet vlefshmërinë në mënyrë të përhershme për objektin e saj kur:

- a) përfundon ose mbyllet veprimtaria e peshkimit profesional;
- b) zotëruesi i saj nuk dëshiron të vazhdojë veprimtarinë e peshkimit të lejuar nëpërmjet kësaj leje/kontrate;
- c) kur subjekti fizik ose juridik nuk paguan gjobat e vendosura për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit;
- d) kur subjekti fizik ose juridik nuk paguan taksën vjetore të lejes/kontratës brenda datës 31 mars të vitit në vazhdim;
- e) në rast se një mjet lundrues, një impiant akuakulture apo objekt tjetër uJOR i kontraktuar nuk përdoret për zhvillimin e veprimtarisë për të cilën është marrë leje ose lidhur kontratë, për një periudhë më shumë se gjashtë muaj. Inspektori i peshkimit bën verifikimin dhe paraqet procesverbalin përkatës në Drejtorinë e Kontrollit për Mjedisin;
- f) në rast të moszbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e lejes ose kontratës dhe lejes mjedisore (në rastet që kërkohet);
- g) në rast se subjekti ka dhënë deklarime ose dokumentacion të rremë në konkurrim, kontrata prishet menjëherë dhe me efekt prapaveprues.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe në rastin e licencave në fuqi, të lëshuara para ndryshimeve sipas ligjit nr. 10 001, datë 6.10.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar”.

Neni 12
Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 10, datë 18.6.2010 “Për përcaktimin e procedurave për pajisjen me leje dhe të konkurrimit publik për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në det, në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore”, shfuqizohen.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

SHTOJCA 1
DETAJIMI I PIKËZIMIT PËR VLERËSIM

1. PA STATUS TË VEÇANTË MJEDISOR

a) Për zonat lagunore me dajlan

Niveli i investimit	Gjithsej		40 pikë
	Vlera totale e investimit		10
	Garancia bankare		5
Vlera e investimit	Gjithsej	25	
	Pastrim dhe mirëmbajtje grykash	10	
	Pellgjet e dimërimit	5	
Veglat e peshkimit	Gjithsej	5	
	Dajlani	2	
	Pinarë	1	
	Mrezha	1	
	Njica dhe grepa	1	
	Të ardhura të deklaruara		5
Teknologjia e projektit	Gjithsej		40 pikë
	Përputhshmëria e peshkimit me dajlan me normat ligjore të fushës së peshkimit dhe ekosistemeve të lagunës		20
	Përdorimi i alternativave të peshkimit, dimerimi, selektiviteti		5



	Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, mrezha, pinarë, njica	5
	Sasia e deklaruar e mjeteve lundruese për peshkim: 2 varka (sanall) me ose pa motor/200 ha	5
	Cilësia e projektit teknik	5
Niveli i punësimit	Gjithsej	20 pikë
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik	6
	Person fizik	4
	Specialistë të fushës si drejtues të projektit 0-10 vjet eksperiencë	1-5
	Numri i peshkatarëve 3/100 ha	1-5

b) Për zonat lagunore pa dajlan

Niveli i investimit	Gjithsej		40 pikë
	Vlera totale e investimit		10
	Garancia bankare		5
	Investime strukturore	Gjithsej	25
		Mirëmbajtja dhe përmirësimi i furnizimit me ujë të ëmbël dhe/ose të kripur	10
		Mirëmbajtje strukturore të zonës ligatinore dhe ruajtja e resurseve natyrore të objektit ujqor të peshkimit	5
	Investime për vegla peshkimi	Gjithsej	5
		Mrezha dhe njica	2
		Pinarë dhe grepa	2
		Sanalle	1
	Garantimi i ripopullimit natyror		5
Teknologjia e projektit	Gjithsej		40 pikë
	Përputhshmëria me kushtet ligjore dhe ekologjike		10
	Përdorimi i alternativave të peshkimit, selektiviteti		10

	Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, mrezha, pinarë, njica, grepa	5
	Sasia e mjeteve të peshkimit në përputhje me kapacitetet natyrore që ka zona	15
Niveli i punësimit	Gjithsej	20 pikë
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik	6
	Person fizik	6
	Specialistë të fushës si drejtues të projektit 0-10 vjet eksperiencë	1-7
	Numri i peshkatarëve 3/100 ha	1-7

2. ME STATUS TË VEÇANTË MJEDISOR

a) Për zonat lagunore me dajlan

Niveli i investimit	Gjithsej		40 pikë
	Vlera totale e investimit		10
	Garancia bankare		5
	Vlera e investimit	Gjithsej	15
		Pastrim dhe mirëmbajtje grykash	10
		Pellgjet e dimërimit	5
	Veglat e peshkimit	Gjithsej	6
		Dajlani	4
		Pinarë	2
		Mrezha	1
		Njica e grepa	1
	Garantimi i ripeshkëzimit natyror		4
Teknologjia e projektit	Gjithsej		40 pikë
	Përputhshmëria e peshkimit me dajlan me normat ligjore të fushës së peshkimit dhe ekosistemeve të lagunës		15
	Teknologjia e dajlanit, forma, selektiviteti i tij, qëndrueshmëria		15
	Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, mrezha, pinarë, njica		2
	Sasia e mjeteve të peshkimit		3



	Skicimi i pellgut/gjeve të dimërimit	5
Niveli i punësimit	Gjithsej	20 pikë
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik	10
	Person fizik	5
	Specialistë të fushës si drejtues të projektit 0-10 vjet eksperiencë	1-5
	Numri i peshkatarëve 2/100 ha	1-5

b) Për zonat lagunore pa dajlan

Niveli i investimit	Gjithsej	40 pikë
	Vlera totale e investimit	10
	Garancia bankare	5
Vlera e investimit	Gjithsej	25
	Mirëmbajtje dhe përmirësimi i furnizimit me ujë të ëmbël dhe/ose të kripur	10
	Mirëmbajtje strukturore të zonës ligatinore dhe mbrojtja e resurseve natyrore në objektin e peshkimit	5
Investime për vegla peshkimi	Gjithsej	5
	Mreza e njica	2
	Pinarë	2
	Grepa	1
	Garantimi i ripeshkëzimit natyror	5
Teknologjia e projektit	Gjithsej	40 pikë
	Përputhshmëria me kushtet ekologjike të zonës	10
Garantimi i një aktiviteti tradicional	Gjithsej	10 pikë
	Aktivitet tradicional	5
	Kapaciteti i peshkimit maksimal 100 kg/ha-minimal 30	0-5

		kg/ha	
	Përputhja e sasisë së mjeteve të peshkimit me kapacitetet natyrore që ka zona		10
	Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, mrezha, pinarë, njica, grepa		5
	Sasia e mjeteve të peshkimit, nr. varkash 2/200 ha		5
Niveli i punësimit	Gjithsej		20 pikë
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik		10
	Person fizik		10
	Numri i peshkatarëve 2/100 ha		1-10

3. PËR UJËMBLEDHËSIT E BUJQËSISË

Niveli i investimit	Gjithsej		40 pikë	
	Vlera totale e investimit		20	
	Garancia bankare	Gjithsej	20	
		1 vit vlera e investimit	5	
		2 vjet vlera e investimit	10	
		3 vjet vlera e investimit dhe mbrojtja e resurseve natyrore në objektin e peshkimit	20	
	Investime për vegla peshkimi	Gjithsej	5	
		Mrezha e njica	2	
		Pinarë	2	
		Grepa	1	
	Garantimi i ripeshkëzimit natyror		5	
Teknologjia e projektit	Gjithsej		40 pikë	
	Përputhshmëria me kushtet ekologjike të zonës		10	
		Garantimi i një aktiviteti tradicional	Gjithsej	10 pikë
			Aktivitet tradicional	5
	Kapaciteti i peshkimit maksimal 100 kg/ha-minimal 30 kg/ha		0-5	
	Përputhja e sasisë së mjeteve të peshkimit me kapacitetet natyrore që ka zona		10	
	Lloji i mjeteve të peshkimit në lagunë, mrezha, pinarë, njica, grepa		5	
	Sasia e mjeteve të peshkimit, nr. varkash 2/200 ha		5	
Niveli i punësimit	Gjithsej		20 pikë	
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik		10	



	Person fizik	10
	Numri i peshkatarëve 2/100 ha	1-10

3. PËR UJËMBLEDHËSIT E BUJQËSISË

Niveli i investimit	Gjithsej	40 pikë
	Vlera e totale investimit	20
	Garancia bankare	
	Gjithsej	20
	1 vit vlera e investimit	5
	2 vjet vlera e investimit	10
	3 vjet vlera e investimit	20
Teknologjia e projektit	Gjithsej	40 pikë
	Niveli i ripeshkëzimit me rasate	
		40
	1000 copë/ha	20
	2000 cope/ha	40
Niveli i punësimit	Gjithsej	20 pikë
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik	10
	Person fizik	5
	Peshkatarë 2/10 ha	10

4. PËR AKUAKULTURËN

Niveli i investimit	Gjithsej	40 pikë
	Vlera e investimit	20
	Garancia bankare	
	Gjithsej	20
	2 vjet vlera e investimit	5
	4 vjet vlera e investimit	10
	6 vjet vlera e investimit	20
Teknologjia e projektit	Gjithsej	40 pikë
	Respektimi i kushteve mjedisore dhe statusi i zonës	20
A	Thellësia e detit ku do të instalohet (akuakulturë me kosha)	
	Gjithsej	20
	Deri në 40 metra	10
	41-50 metra e më tutje	20
B	Akuakultura tokësore ose ligatinore	
	Gjithsej	20
	Cikël i plotë	20

		Cikël i pjesshëm {rritje (majmëri) ose prodhim rasatesh}	15
Niveli i punësimit	Gjithsej		20 pikë
Forma juridike e shoqërisë	Person juridik		6
	Person fizik		3
	Specialistë të fushës, si drejtues të projektit, 0-10 vjet eksperiencë		1-7
	Numër punonjësish		1-7

1. PËR AKUAKULTURËN E MIDHJEVE ME IMPIANTE FIKSE NË BUTRINT

Niveli i investimit	Gjithsej		40 pikë
	Vlera e investimit dhe e mirëmbajtjes		20
	Garancia financiare	Gjithsej	20
		1 vit vlera e investimit	5
		2 vjet vlera e investimit	10
		3 vjet vlera e investimit	15
		4 vjet vlera e investimit	20
Teknologjia e projektit	Gjithsej		40 pikë
	Funksionim i impiantit me kapacitet të plotë, rendiment të lartë prodhimi		20
	Procesi teknologjik i kultivimit të midhjeve	Gjithsej	20
		Grumbullimi i farës në zonën A ose B	10
		Ajrosja e midhjeve dhe sigurimi i një produkti cilësor	10
Niveli i punësimit	Gjithsej		20 pikë
	Eksperienca në kultivimin e midhjeve		1-10 pikë
	Numër punonjësish për impiant		1-10 pikë



2. PËR LUMENJ DHE GJIRE DETARE (MJETE STACIONARE, SI STAVNIKË DHE BILANXHE)

Niveli i investimit	Gjithsej	40 pikë	
	Vlera e totale investimit	20	
	Garancia bankare	Gjithsej	20
		1 vit vlera e investimit	5
		2 vjet vlera e investimit	10
		3 vjet vlera e investimit	20
Teknologjia e projektit	Gjithsej	40 pikë	
	Pozicionimi i mjetit stacionar	Gjithsej	40
		Distanca nga bregu, nga grykat, nga subjekti analog me i afërt etj.	1-20
		Mosbllokimi i qarkullimit të peshqve	1-20
Niveli i punësimit	Gjithsej	20 pikë	

SHTOJCA 2
KONTRATË TIP PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT TË UJËRAVE TE BRENDSHME DHE
AKUAKULTURË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KOMISIONI I PËRHERSHËM I VLERËSIMIT TË KËRKESAVE TË PARAQITURA
PËR KONKURRIM PUBLIK, PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË
UJËRAT E BRENDSHME DHE TË AKUAKULTURËS

Adresa: Rruga e Durrësit, nr. 27, Tiranë, Tel.: 2 270 630, Fax: 2 270 627 -
www.moe.gov.al

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .20

KONTRATË
PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS

Në zbatim të nenit 31, pika 6 e ligjit 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar; nenit 659 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2 të nenit 3 të rregullores nr. 12, datë ____ . ____ . ____ “Për përcaktimin e procedurave për pajisjen me leje dhe të konkurrimit publik për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në det, në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore detare”.

E lidhur sot në datë ____ . ____ .201_ , midis palëve të mëposhtme:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, z/znj. _____ , me seli: Rruga e Durrësit, nr. 27, Tiranë, Tel.: 2 270 630, Fax: 2 270 627.

Subjekti fizik _____ me numër NIPTI _____ , me adresë: _____ .

Neni 1
Objekti i kontratës

1. Kjo kontratë ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit të peshkimit dhe/ose akuakulturës nga ana e subjektit fizik/juridik _____ në (objektin ujor me sipërfaqe _____ , në komunën _____ , rrethi _____ , qarku _____ , të shpallur fitues nga ana e MMPAU-së në konkurrimin publik të zhvilluar më datë _____ .

2. MMPAU-ja i njuh të drejtën e zhvillimit të aktivitetit të peshkimit dhe/ose akuakulturës, subjektit _____ brenda të gjithë kuadrit ligjor që rregullon këtë aktivitet, në zonën e përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 1.



Neni 2

Afati i kontratës

Kjo kontratë fillon nga data e nënshkrimit të saj, nga palët dhe ka një afat ____ (me shkrim) vjeçar. Me përfundimin e afatit të saj, kjo kontratë konsiderohet e zgjidhur.

Neni 3

E drejta e peshkimit

Subjekti fizik/juridik _____ gëzon të drejtën të zhvillojë aktivitetin e peshkimit dhe/ose akuakulturës në objektin ujor _____, me sipërfaqe _____ komuna _____, rrethi _____, qarku _____.

Në zonën me koordinata:

Kufizimet

Koordinatat

Veri _____

X _____

Y _____

Jug _____

X _____

Y _____

Lindje _____

X _____

Y _____

Perëndim _____

X _____

Y _____

Neni 4

Pagesa dhe regjimi i saj

1. Subjekti fizik/juridik _____ do të kryejë pagesën mbi të drejtën e zhvillimit të aktivitetit të peshkimit në vlerën e përcaktuar nga shtojca 4 e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” për llogari të degës së tatimeve Tiranë në nr. e llogarisë: 0108030785.

2. Pagesa e parë do të kryhet menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 6 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

3. Pagesat në vitet e tjera do të kryhen brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim.

Neni 5

Detyrat e palëve kontraktuese

1. Subjekti fizik/juridik _____ zbaton detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, si më poshtë:

- Për akuakulturën, në sipërfaqe _____, me koordinata _____, me volume të instaluar ujore, _____, në njësinë administrative të _____ me intensitet kultivimi _____, të llojeve _____, me normë peshkëzimi _____, me trajtim ushqimor _____, me trajtime të tjera _____, për realizimin e sasisë së prodhimit _____, tregtuar në _____, me peshë/individë _____, me deklarime statistikore pranë monitorëve lokalë deri më 31 mars të vitit në vazhdim.

- Për peshkimin në sipërfaqen ujore (me koordinata) _____ /lagunën/njësinë lagunore/lumin/liqenin (natyror/artificial) të _____, në njësinë administrative të _____ për peshkimin (lloji i peshkimit) _____, të llojeve të peshkut _____, në sasinë _____, me mjetet/veglat e peshkimit _____, për periudhën e gjuetisë _____, tregtuar me deklaratë shitjeje dhe deklarime statistikore deri në datën 5 të çdo muaji, pranë monitorëve lokalë.

- Për kultivimin e midhjes në liqenin e Butrintit, në impiantin/et _____, me koordinata _____, për farëzimin, mbledhur në zonën _____, me dendësi farëzimi _____, realizimin e rendimentit për impiant _____, për pas trajtimin e prodhimit në qendrën e kontraktuar _____, etiketimin dhe tregtimin konform legjislacionit dhe/apo skemave kualitative dhe të sigurisë ushqimore _____.

2. MMPAU-ja, nëpërmjet strukturave të saj, merr masa, brenda kompetencave të saj ligjore, për të siguruar respektimin e të drejtës së peshkimit, të dhënë subjektit të mësipërm.

3. MMPAU-ja gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e subjektit.

4. MMPAU-ja mund të kërkojë në çdo kohë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e saj të parakohshëm, kur kontraktuesi dëmton, si dhe nuk përmbush në mënyrë të dukshme detyrimet që rrjedhin nga kontrata, si dhe në rastet e shkeljeve të përsëritura ligjore, të konstatuara në fushën e veprimtarisë.

5. MMPAU-ja ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur kontraktuesi nuk ka shlyer vlerën e taksës së zhvillimit të aktivitetit të përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

6. Kontraktuesi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e objektit, të tretëve, duke mos përfshirë këtu shoqëritë e kontrolluara prej saj.

7. Kontraktuesi nuk ka të drejtë të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjera.

8. Kontraktuesi ka për detyrim të lejojë dhe të shoqërojë inspektoratin e peshkimit dhe vëzhguesit/monitorët e MMPAU-së të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara nga kontrata, si dhe të kryejnë detyrat funksionale në bazë të legjislacionit në fuqi.

9. Kontraktuesi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë të re ligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e peshkimit dhe akuakulturës.

10. Në rast se për sipërfaqet objekt kontrate merren vendime nga KKT-ja apo KKU-ja, të cilat bien ndesh me aktivitetin, leje peshkimi/kontrata e peshkimit/akuakulturës revokohet, pa asnjë detyrim për palët kontraktuese.

11. Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen dispozitat ligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës me masën e gjobës dhe me heqjen e lejes apo prishjen e kontratës.

Neni 6

Përtëritja e kontratës

Me mbarimin e afatit të kontratës, zona e përcaktuar shpallet për konkurrin publik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të dyja palët do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis tyre gjatë zbatimit të detyrimeve të kësaj kontrate, me shkrim dhe nëpërmjet bisedave të drejtpërdrejta.

Në rast të kundërt, secila nga palët mund t'i drejtohet gjykatës. Vendi i gjykimit është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Kjo kontratë u përpilua në 4 (katër) kopje të barasvlershme.

PALËT KONTRAKTUESE:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	Subjekti fizik/juridik
--	------------------------



SHTOJCA 3
KONTRATA PËR DHËNIEN ME QIRA TË SIPËRFAQEVE UJORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DREJTORIA E PESHKIMIT

Adresa: Rruga e Durrësit, nr. 27, Tiranë, Tel.: 2 270 630, Fax: 2 270 627 -
www.moe.gov.al

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .20

KONTRATË QIRAJE
PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE UJORE PËR AKUAKULTURË
INTENSIVE

Në Tiranë, sot në datë ____ . ____ . ____ , në zbatim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 13.5.2009 “Për procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore, për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”, pika 11 e tij, lidhet kjo kontratë qiraje midis:

I. PALËT:

1. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, e përfaqësuar nga _____, e cila në këtë kontratë është “Qiradhënësi” dhe kështu do të thirret më poshtë.

2. Subjekti i peshkimit _____, regjistruar si person fizik/juridik me NIPT _____, i shpallur fitues në konkurrimin e datës _____, dhe pajisur me lejen e mjedisit me vendimin nr. _____, nr. ____ prot. datë ____ . ____ .20____, përfaqësuar nga _____, i cili në këtë kontratë është “Qiramarrësi” dhe kështu do të thirret më poshtë.

II. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i kontratës

“Qiradhënësi” jep me qira sipërfaqe ujore prej _____ ha, të ndodhur në zonën detare/ në ujërat e brendshme të qarkut _____, në liqenin natyror _____, në zonën detare _____ të ndodhur në bashkia/komuna _____, kategoria _____ me kufizime nga:

Kufizimet

Veri _____

Jug _____

Lindje _____

Perëndim _____

Koordinatat

X _____ Y _____

X _____ Y _____

X _____ Y _____

X _____ Y _____

Për ushtrimin e veprimtarive të akuakulturës intensive sipas qëllimit dhe destinacionit të përcaktuar në kontratën e ushtrimit të aktivitetit dhe lejen e mjedisit për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës.

Neni 2

Qëllimi

Kjo kontratë ka si qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes ujore të përcaktuar në pikën 1, për të ushtruar aktivitetin e akuakulturës intensive nga subjektet e peshkimit, të pajisur me kontratë për zhvillimin e këtij aktiviteti dhe leje mjedisore, sipas kërkesave të përcaktuar në to.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kontrata për dhënien me qira të kësaj sipërfaqeje ujore lidhet në datën efektive të dhënies së kontratës së ushtrimit të aktivitetit. Afati i kësaj kontrate është i njëjtë me kohëzgjatjen e kontratës së ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës intensive dhe vlefshmëria e saj do të jetë deri në mbarimin e afatit të përcaktuar në të drejtën e zhvillimit të aktivitetit.

(_____ / _____ / _____)
data muaji viti

Neni 4

Vlera dhe pagesa e qirasë vjetore

Pagesa e qirasë është vjetore dhe bëhet në të njëjtën kohë me pagesën e të drejtës së zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës. Për vitet pasardhëse pagesa do të kryhet në fillim të vitit kalendarik.

Qiraja është në vlerën 1 €hektar/ vit.

Pagesa do të bëhet në numrin e llogarisë të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me emërtimin: “Pagesa e qirasë nga subjekti _____, për përdorimin e sipërfaqes ujore për akuakulturë intensive”.

III. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

Neni 5

Qiradhënësi garanton gëzimin dhe përdorimin e qetë të kësaj sipërfaqeje ujore, objekt të kësaj kontrate, nga pretendime që mund të ngrihen nga të tretët në lidhje me të drejtën e administrimit të kësaj sipërfaqeje ujore.

Neni 6

Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit.

Neni 7

Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel për dy periudha rresht detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit me shkrim 15 ditë përpara.



IV. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

Neni 8

Me pajisjen me lejen mjedisore dhe kontratën për ushtrimin e veprimtarisë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, qiramarrësi detyrohet që në fillim të aktivitetit të akuakulturës intensive dhe çdo fillim viti kalendarik të lidhë dhe të kryejë pagesën e kontratës së aktivitetit dhe të kontratës së nënshkruar, pavarësisht nga kohëzgjatja e tyre.

Neni 9

Qiramarrësi detyrohet të paguajë qiranë vjetore sipas kërkesave të nenit 4 të kontratës.

Neni 10

Qiramarrësi ka për detyrë që ta shfrytëzojë dhe ta përdorë sipërfaqen ujore, objekt të kësaj kontrate, për të nxjerrë të ardhura vetëm sipas qëllimit, destinacionit dhe kohëzgjatjes së parashikuar në nenin 2 dhe 3 të kontratës.

Neni 11

Qiramarrësit nuk i lejohet që sipërfaqen e dhënë me qira, ta japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një personi tjetër, duke mos përfshirë këtu shoqëritë e kontrolluara prej saj.

Neni 12

Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë sipërfaqen e dhënë në përdorim të padëmtuar.

Neni 13

Për qëllimet e kësaj kontrate, me “Forcë madhore” do kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmytjet, lufta. Në këto raste, qiramarrësi është i detyruar të njoftojë me shkrim qiradhënësin dhe të hyjnë në bisedime me njëri-tjetrin për rregullimet e mundshme kontraktore, duke lidhur një aneks-kontratë të re midis tyre.

Për kohën e vazhdimit të forcës madhore, qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet e pagesës për moskryerjen e aktivitetit për këtë shkak.

V. ZGJIDHJA E KONTRATËS

Neni 14

Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

Kontrata mund të zgjidhet përpara mbarimit të saj:

- a) në marrëveshje midis palëve;
- b) kur qiramarrësi e dëmton dhe e shpërdoron sipërfaqen e marrë në përdorim dhe shfrytëzim;

c) kur subjektit në fjalë i hiqet leja mjedisore, për shkak të ndryshimit të cilësisë së ujërave, nga veprimtaria e akuakulturës intensive që ai kryen, kur shkel dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, rregulloren e dalë në zbatim të këtij legjislacioni; si dhe

d) kur subjektit i priset kontrata e të drejtës së zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës.

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 15

Palët detyrohen të zbatojnë detyrimet e vendosura në këtë kontratë.

Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtohen në kontratën e qirasë.

Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim të palëve; në të kundërt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata i bashkëngjitet kontratës së zhvillimit të aktivitetit të akuakulturës nr. ____ .prot. datë _____ të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Kontrata pasi u lexua nga të dyja palët, ranë dakord me përmbajtjen e saj dhe e nënshkruan atë.

Kjo kontratë qiraje u formulua në 4 (katër) kopje të barasvlershme.

PALËT KONTRAKTUESE

QIRADHËNËSI

Ministria e Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit të Ujërave

QIRAMARRËSI

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

(_____)

(_____)



VENDIM
Nr. 66, datë 6.6.2012

**MBI MIRATIMIN E STANDARDEVE TË TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË KLIENTËVE
TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA TË LICENCUARIT PËR AKTIVITETET E
SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME PAKICË TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, Kodit të Matjes, miratuar me vendimin nr. 101, datë 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Kodit të Shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, kushteve të përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë, miratuar me vendimin nr. 108, datë 21.10.2011 të Entit Rregullator të Energjisë, kushteve të përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë, miratuar me vendimin nr. 109, datë 21.10.2011 të Entit Rregullator të Energjisë, rregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 110, datë 21.10.2011 të Entit Rregullator të Energjisë, dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuara, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 6.6.2012, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Të miratojë standardet e trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike nga të licencuarit për aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike. (Rregullorja, bashkëngjitur këtij vendimi.)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 korrik 2012.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

STANDARDET E TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË KLIENTËVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA TË LICENCUARIT PËR AKTIVITETET E SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME
PAKICE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Këto standarde kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike dhe të rritet besimi dhe pëlqimi i konsumatorëve për këtë shërbim të ofruar nga të licencuarit.

Neni 2
Objekti

Objekti i këtyre standardeve është përcaktimi i kushteve të përgjithshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të klientëve të energjisë elektrike nga të licencuarit për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike.

Neni 3
Baza ligjore

Këto standarde hartohen në mbështetje të:

- Ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (të ndryshuar).
- Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.
- Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Kodit të Matjes, miratuar me vendimin nr. 101, datë 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike.
- Kodit të Shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike.
- Kushteve të përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë, miratuar me vendimin nr. 108, datë 21.10.2011 të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike.
- Kushteve të përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë, miratuar me vendimin nr. 109, datë 21.10.2011 të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike.
- Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 110, datë 21.10.2011.

Neni 4
Përkufizime

Termet e mëposhtëm të përdorur në këto standarde kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. “Ankesë e klientit” do të thotë shprehja e pakënaqësisë nëpërmjet postës, *email*-it, telefonit apo fizikisht nga ana e klientit, në lidhje me një ose disa shërbime të ofruara nga i licencuari, për të cilën kërkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë një përgjigje apo një zgjidhje prej të licencuarit.



2. “Kërkesë e klientit” do të thotë kërkitimi i një informacioni, këshille apo veprimi të ndryshëm nga ankesa, e cila bëhet nga ana e një klienti, në lidhje me një ose disa shërbime të ofruara nga i licencuari.

3. “I licencuari” do të thotë personi përgjegjës i licencuar nga ERE, sipas ligjit nr. 9072 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes dhe/ose për të furnizuar klientët tariforë.

PJESA E DYTË STANDARDET E TRAJTIMIT TË ANKESAVE/KËRKESAVE

Neni 5 Informimi

1. I licencuari duhet të sigurojë në mënyrë lehtësisht të disponueshme për klientët, ankuesit dhe palët e tjera të interesuara, informacionin minimal të nevojshëm për procedurat e trajtimit të ankesave, i cili duhet të pasqyrohet dukshëm në faturën e konsumit të energjisë elektrike. Gjithashtu, i licencuari duhet t’i ofrojë klientëve publikime të këtij informacioni edhe në formën e broshurave apo në formë elektronike.

2. Ky informacion duhet të jetë në një gjuhë të qartë dhe në një format të aksesueshëm për të gjithë.

3. Informacioni duhet të përmbajë minimalisht:

- a) të drejtat e klientëve;
- b) vendet apo zyrat ku mund të bëhen ankesat;
- c) mënyrën si mund të bëhet ankesa;
- d) çfarë informacioni duhet të sigurojë për një ankesë (të tilla si: detaje në lidhje me identitetin dhe vendndodhjen e ankuesit, problemi i hasur, datën dhe vendin e ndodhjes së problemit, nëse ankuesi kërkon ndonjë zgjidhje, si dhe dokumentacioni i nevojshëm mbështetës).

Neni 6 Pranimi dhe regjistrimi i ankesave

1. Menjëherë pas pranimit, ankesa duhet të regjistrohet në format elektronik apo të shkruar, në formën e një regjistrimi.

2. Regjistrimi duhet të përfshijë:

- a) një kod unik identifikues;
 - b) mënyrën e paraqitjes së ankesës;
 - c) emrin, vendndodhjen dhe datën e paraqitjes së ankesës;
 - d) identitetin e parashtruesit të ankesës dhe detajet e kontaktit të ankuesit;
 - e) një përmbledhje të ankesës;
 - f) një kategorizim të llojit të klientit apo konsumatorit, sipas nivelit të tensionit dhe tarifave;
 - g) llojin e ankesës;
 - h) vendin në të cilin ka ndodhur ngjarja për të cilën ankohet;
 - i) nëse klienti është ankuar më parë apo jo për të njëjtën ngjarje për të cilën bëhet ankesa.
3. Pranimi dhe trajtimi i ankesave të klientëve duhet të jetë shërbim i ofruar pa pagesë nga ana e të licencuarit.

Neni 7

Trajtimi i ankesave

1. Nëse ankesa është marrë personalisht ose me anë të telefonit, personi i ngarkuar nga ana e të licencuarit, do të regjistrojë sipas pikës 6.2, atë që i është komunikuar klientit në lidhje me veprimin e propozuar që do të ndërmerret për të zgjidhur ankesën, datën e parashikuar për zgjidhjen e ankesës dhe mënyrën e komunikimit që do të ndiqet në vazhdimësi siç është rënë dakord me ankuesin.

2. Nëse ankesa është pranuar me postë, brenda [5] ditëve pune pas pranimit të ankesës, i licencuari do të informojë me shkrim klientin për kodin e regjistrimit, veprimin e propozuar për zgjidhjen e ankesës, datën e parashikuar për zgjidhjen e ankesës dhe mënyrën e komunikimit që do të ndiqet në vazhdimësi me ankuesin.

3. Të gjitha komunikimet ndërmjet të licencuarit dhe ankuesit lidhur me ankesën do të regjistrohen duke respektuar kodin unik identifikues.

Neni 8

Zgjidhja e ankesës

1. I licencuari do të bëjë çdo përpjekje për të hetuar dhe verifikuar të gjitha rrethanat dhe të dhënat lidhur me ankesën e regjistruar.

2. I licencuari mund të kërkojë informacion shtesë nga ankuesi brenda [5] ditëve pune pas pranimit të ankesës.

3. Pas hetimit, i licencuari duhet të informojë ankuesin për veprimet e ndërmarra për të zgjidhur ankesën dhe për të shmangur problemin.

4. Në rastet ku ankesa rezulton e drejtë, veprimet korrigjuese apo kompensimi i klientit bëhet në përputhje me “Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë/jofamiljarë” dhe rregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”.

5. Afati maksimal i trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave është [30] ditë pune nga regjistrimi i ankesës.

Neni 9

Komunikimi i vendimit

1. Vendimi ose çdo veprim i ndërmarrë për zgjidhjen e ankesës, duhet t'i komunikohet ankuesit brenda [5] ditëve pune nga data e marrjes së vendimit.

2. Vendimi i marrë për ankesën duhet të përmbajë bazën ligjore, si dhe elementet e tjera të parashikuara në aneksin 1 të këtyre standardeve.

Neni 10

Ankesa në lidhje me veprimet e një punonjësi

1. Nëse ankesa ka të bëjë me veprimet e një punonjësi të të licencuarit, ankuesi duhet të sigurohet që të dhënat personale të ankuesit do të mbahen konfidenciale, për aq kohë sa të jetë e nevojshme për zgjidhjen e ankesës.

2. I licencuari duhet t'i japë mundësi punonjësit për të shpjeguar rrethanat në të cilat ka ndodhur sjellja e ankuar.

3. Nëse ankesa në lidhje me sjelljen e një punonjësi rezulton e pabazuar dhe nuk kërkon një masë disiplinore, punonjësit duhet t'i jepen udhëzimet e duhura se si të përmirësojë sjelljen dhe veprimet e tij në lidhje me konsumatorët dhe/ose klientët.



Neni 11

Analiza, vlerësimi dhe monitorimi i procedurave për trajtimin e ankesave

1. I licencuari duhet çdo tre muaj të analizojë ankesat e pranuar për të identifikuar problematikat e përsëritura, me qëllim eliminimin dhe minimizimin e problemeve të tilla në të ardhmen dhe përmirësimin e shërbimit.
2. I licencuari do bëjë një klasifikim të ankesave, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtyre standardeve.
3. I licencuari do të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit, një herë në vit problematikat, masat dhe veprimet e ndërmarra për eliminimin e tyre.
4. I licencuari duhet të monitorojë performancën e trajtimit të ankesave, për të siguruar që ajo i plotëson standardet e përcaktuara në këtë rregullore.
5. I licencuari do të testojë periodikisht çdo 6 muaj, nivelin e kënaqësisë së klientëve me procedurën e trajtimit të ankesave, me kryerjen e sondazheve të rastësishme të ankuesve.
6. Rezultatet e sondazheve të kryera nga i licencuari do të publikohen në faqen e internetit të të licencuarit.

Neni 12

Paraqitja e ankesës në ERE

1. Çdo klient ka të drejtë të drejtohet për ankesë pranë ERE-s në këto raste:
 - pasi të ketë përfunduar procedurën e trajtimit të ankesave pranë të licencuarit dhe nuk mbetet i kënaqur nga përgjigja e dhënë nga i licencuari;
 - në rast se ankuesi nuk merr një përgjigje nga i licencuari brenda afatit të parashikuar në nenin 8 të këtyre standardeve;
2. Në çdo rast i licencuari duhet t'i bëjë të ditur ankuesit të drejtën e tij për të ankimuar vendimin e tij në ERE.
3. Nëse klienti zgjedh t'i drejtohet ERE-s për shqyrtimin e ankesës së tij, i licencuari duhet t'i sigurojë parashtruesit të ankesës një kopje të procesverbalit të hartuar për ankesën e tij, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për trajtim nga ERE.
4. Rekomandimet e ERE-s për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave janë të detyrueshme për të licencuarin.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË TJERA

Neni 13

Procedura e brendshme e trajtimit të ankesave

1. Brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtyre standardeve, i licencuari do të miratojë një procedurë të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave, në përputhje me këto rregulla.

Neni 14

Publikimi i standardeve

Këto standarde, së bashku me procedurën e brendshme të të licencuarit për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të klientëve, publikohen në faqen zyrtare të internetit të të licencuarit dhe në të gjitha zyrat e kujdesit ndaj klientit të të licencuarit dhe mund t'u vihen në dispozicion çdo klienti apo subjekti të interesuar.

Neni 15
Përmirësimi dhe rishikimi i procedurave të brendshme të trajtimit të ankesave

I licencuari duhet të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme procedurat e brendshme të trajtimit të ankesave, me qëllim që të përmirësojë efektivitetin e procesit të trajtimit të ankesave. I licencuari duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të eliminuar shkaqet e problemeve ekzistuese, të cilat kanë ndikuar ose në të ardhmen mund të vazhdojnë të ndikojnë në paraqitjen e ankesave.

Neni 16
Konfidencialiteti

I licencuari është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit për çdo informacion apo dokument të vënë në dispozicion nga klienti, në lidhje me një ankesë të paraqitur nga ky i fundit.

Neni 17
Raportimi në ERE

1. I licencuari do të paraqesë në ERE çdo tre muaj një raport të detajuar me shkrim, i cili do të përmbledhë:

- a) Numrin e ankesave të marra në tremujorin përkatës, të kategorizuara sipas:
 - i) kategorive të klientit;
 - ii) objektit të ankesës (sipas aneksit nr. 2);
 - iii) zona apo njësia administrative vendore, në të cilin ka ndodhur ngjarja për të cilën është paraqitur ankesa;
- b) Numri i ankesave për secilën kategori që janë zgjidhur në përputhje me pritshmërinë e kërkesave të klientit;
- c) Numri i ankesave për secilën kategori që nuk janë zgjidhur në përputhje me pritshmërinë e klientit;
- d) Hapat dhe veprimet që ka ndërmarrë i licencuari për të zgjidhur çdo kategori të problemeve, sipas zonave apo njësive administrative vendore.

2. ERE mund të kërkojë informacion shtesë në lidhje me raportin përmbledhës, nëse e gjykon të nevojshme.

3. Raportet përmbledhëse tremujore, si dhe çdo informacion shtesë të kërkuar nga ERE, do të publikohen në faqen e internetit të licencuarit menjëherë pas dorëzimit në ERE.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Këto standarde hyjnë në fuqi me miratimin e saj në datën 1 korrik 2012.



ANEKSI 1 ELEMENTET KRYESORE TË PËRGJIGJES PËR TRAJTIMIN E ANKESËS

Elementet kryesore që përmban përgjigjja që i licencuari i dërgon klientit në lidhje me një ankesë/kërkesë, sipas problematikës së trajtuar:

- procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës;
- veprimet e ndërmarra;
- mënyra e korrigjimit të veprimit;
- baza ligjore;
- afati për kryerjen e veprimeve korrigjuese;
- kompensimet e mundshme;
- riparimet e mundshme;
- asistencë teknike;
- informacion i nevojshëm;
- referim për trajtim të problemit;
- asistencë tjetër;
- kërkesë ndjese;
- tregimi i ndryshimit të procesit, politikës apo procedurës që ka ndodhur si rrjedhojë e ankesës;
- adresimi i të gjitha aspekteve të ankesës.

ANEKSI 2 KLASIFIKIMI I ANKESAVE

Kategoria e ankesës	Specifikimet
Lidhja me rrjetin	Tarifa
	Vonesa
	Pengesa për lidhjen
	Tjetër
Matja	Leximi i matësit
	Funksioni i matësit
	Tjetër
Cilësia e furnizimit	Cilësia e furnizimit (tensioni)
	Vazhdimësia e furnizimit
	Tjetër
Praktika të padrejta tregtare	
Kontrata dhe shitje	Kushte të padrejta kontraktuale
	Mungesë informacioni
	Konfirmim i urdhrat
	E drejtë e tërheqjes
	Pagesat
	Tërheqje nga kontrata
	Periudha minimale kontraktuale
	Çështje të tjera lidhur me kontrata dhe shitje
Aktivizimi	Lidhja

	Rilidhja pas ndërprerjes
Ndërprerje si rrjedhojë e mospagesës apo pagesës së vonuar	
Fatura dhe vlerë totale debie	Faturë e gabuar
	Faturë e paqartë
	Mosdalje e faturës apo vështirësi në aksesin e faturës
	Faturë e pajustificuar
	Vlerë totale debie
	Çështje të tjera
Çmimet/tarifat	Ndryshim i çmimeve/tarifave
	Diskriminim në bazë çmimi
	Transparencë e tarifës
	Tarifë sociale
	Çështje të tjera
Riparimi	
Ndryshim operatori	Vonesa
	Ndryshim i padëshiruar
	Të tjera

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 11.7.2012
Doli nga shtypi më 13.7.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë